




KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL VI /2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 6 (gjashtë) për vitin 2025 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 27.06.2025
Ora: 10:00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci
Z.Selman Kolgeci
Z. Flamur Bytyçi
Z. Urim Suka
Z. Kushtrim Kuçi
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj.Doruntina Zenelaj
Z.Alban Berisha
Z. Bexhet Kuçi
Z. Reshat Selimaj
Z. Lirim Qatani
Z. Aziz Bytyqi
Znj.Sanie Kuçi-
Rexhepaj
Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina
Z. Vullnet Luzhnica
Z. Xhevshet Gashi
Z.Edon Sadikaj
Znj.Saranda
Bajraktari
Znj.Mimoza Bajraktari
Znj.Festë Kabashi
Z.Dardan Berisha
Z.Bajram Basha
Znj.Mevlude Kabashi
Znj.Sheqerije Zyrapi
Znj.Laureta Tafaj
Z.Liridon Fandaj
Z.Qëndrim Elshani
Z.Herolind Limaj
Znj.Jehona Lumi
Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për bonuset e zonimit për Komunën e Suhrekës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për hapjen e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit Plani Rregullues i Hollësishëm për „Zonën Ekonomike në Duhël“ ;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për periudhën 2026-2028;**
- 5. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

24 për, 3 kundër, Miratohet rendi i ditës

Nënkryetarja - Përsëritet të pranishmit. Sot e ndiej një detyrim moral dhe institucional si përfaqësuese e gjinisë femërore,si nënkryetare e komunës dhe si aktiviste e hershme për të drejtat e njeriut që të ngre zërin për një çështje që nuk duhet të anashkalohet. Është dhuna ndaj grave në politikë, gjuha denigruese që po ashpërsohet dita e ditës e sidomos tani kur po afrohet fushata për zgjedhjet lokale. Nuk është në rregull që gratë në politikë të stigmatizohen apo të përballen me sulme vetëm se guxojnë të jenë pjesë e vendimmarrjes, por komuna jonë ka bërë hapa të rëndësishëm drejt përfshirjes së grave në jetën publike por ky proces kërkon vullnet të përbashkët për të garantuar siguri, respekt dhe hapësirë për të vepruar. Komuna jonë deri më tani shquhet për respekt dhe mirësjellje ndaj gjinisë femërore andaj dua të ju falemderoj të gjithëve për mbështetjen unanime në marrjen e vendimeve në të mirë të gjinisë femërore. Apeloj që si përfaqësues të zgjedhur të qytetarëve të vazhdojmë të jemi shembull i përgjegjësive politike dhe qytetare që sëbashku të angazhohemi për një klimë politike të ndërtuar mbi respekt, etikë dhe kulturë demokratike ku gratë dhe burrat mund të garojnë, mund të debatojnë dhe të kontribojnë në mënyrë të barabartë dhe dinjitoze. Ju falemderoj dhe ju ftoj që sëbashku të refuzojmë gjuhën e urrejtjes, provokimet dhe ndarjet. Le të jemi një shembull për qytetarët tanë,ndonëse të ndryshëm në ide mud të gjejmë gjuhën e përbashkët për të mirën e përbashkët.

Laureta Tafaj - Përsëritet të pranishmit. Të nderuar kolegë të KPF-së,ju të cilët i keni kundërshtu të gjitha pikat në KPF,sot vetëm tre anëtarë të Asamblesë ishin kundër.Kryesues,a mund të na japësh përgjigje se si mund ta vazhdojmë sot këtë mbledhje kur në një formë po ia hup të gjitha kompetencat KPF-së.Nëse asnjë pikë nuk t'ka kalu në KPF,të njehta pika i ke sjell sot.

Kryesuesi - është vërtetë ajo që the ti por kisha të drejtë ligjore m'i përcjell pikat për Asamble.KPF është një komision këshilldhënës dhe rekomandues,andaj ma ka dhënë këtë mundësi ligji.

Urim Suka - ne në KPF e kemi pas një rend dite të njejtë përpara të cilin e kemi miratu për rend dite mandej për pikat,i kemi pas qëndrimet tona. Edhe sot po e miratojmë rendin e ditës por për pikat i kemi qëndrimet tona. Bazën ligjore që ju e keni shfrytëzu,ne jemi konsultu me juristat dhe kemi ardhë në një përgjigje që Kryesuesi në bashkëpunim me Kryetarin e ka të drejtën me thirr seancën.

Sanie Kuçi Rexhepaj - përsëritet të pranishmit.Në këtë mbledhje dua të ndaj me ju një vendim të rëndësishëm në vazhden e angazhimit tim publik.Nga sot do të vazhdoj mandatin tim si anëtare e Kuvendit Komunal në përbërje të LDK-së. Ky nuk është një vendim i marrë lehtë,është rezultat i një reflektimi të kujdesshëm mbi rrugëtimin tim si përfaqësuese e qytetarëve mbi mënyrën se si dua të kontriboj në këtë kuvend dhe mbi hapësirën politike që ma mundëson të veproj me efektivitet të plotë, profesional dhe etik. Ndërrimi i angazhimit tim politik nuk përbën ndryshim dhe vlera dhe as se ndryshon përkushtimin tim për të vepruar drejtë,me përgjegjësi dhe integritet. Pavarësisht formës politike

që më përfaqëson,qëllimi im mbetet i pa ndryshuar,të jem zë i qytetarëve,ti mbroj interesat publike dhe të punoj për politika që sjellin zhvillim të qëndrueshëm për komunën tonë. E vlerësoj bashkëpunimin e deritanishëm me kolegët nga grupi i AAK-së. Çdo përvojë e përbashkët,çdo proces vendimmarrës ka qenë një pjesë e rëndësishme e kontributit tim institucional.Gjithëashtu dua të shpreh falemnderim për mirëpritjen dhe gadishmërinë e grupit të LDK-së për të bashkëpunuar në frymën e respektit dhe angazhimit të ndërsjelltë.Ky vendim nuk është një hap për të ndryshuar drejtim por një përpjekje për të rritur ndikimin tim në drejtimin që gjithmonë kam synuar,një Suharekë të zhvilluar,me planifikim të mirëfilltë,me pjesmarrje të gjërë dhe me vendimmarrje të ndershme.Jam zgjedhur nga qytetarët për të përfaqësuar me përgjegjësi dhe besoj thellësisht se besimi i dhënë nuk i përket një subjekti por bindjes se dikush do të veproj për të mirën e përbashkët.Do të vazhdoj të jem aktive në çdo iniciativë që përmirëson jetën në komunën tonë. Do të jem e zëshme aty ku duhet të mbrohen të drejtat dhe pa lëkundur aty ku nevojitet vendosshmëria.

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-Rregullore për bonuset e zonimit për Komunën e Suhrekës;

Kryesuesi - hap debatin për pikën 2.

Liridon Fandaj - kjo projekt-rregullore në Asamblenë e kaluar nuk ka kalu,po ashtu nuk ka kalu edhe në KPF.Kjo projekt-rregullore nuk ka ndryshu që të sillet prap në Asamble,po ashtu dhe kërkesat tona nuk janë marrë parasysh. Kjo projekt-rregullore ia jep të drejtën ekskluzive një Kryeytari të komunës për me formu një komision,e ja heq atë të drejtë kësaj Asambleje.Për deri sa kjo rregullore kërkohet të votohet në Asamble,do të duhej që të drejtat dhe kompetencat ti ketë kjo Asamble për komisionin dhe të gjitha procedurat tjera. Andaj si rregullore është e papranueshme dhe nuk do të votohet në këtë Asamble.

Selman Kolgeci - sa i përket kësaj rregullore,unë kur e pashë si pikë në rend dite mendova që kanë reflektu Drejtoria e Urbanizmit por pash dy dokumente të njejta.Një dokument që është diskutu këtu dhe i kemi dhënë secili vërejtjet tona,nuk janë përfshi në ndryshimin e ri.Pse duhet me ardhë edhe një herë me u diskutu kjo? Unë po e shoh si trysni ndaj anëtarëve të Kuvendit dhe kërkoj me heq dorë drejtori ose me i përfshi ndryshimet dhe kërkesat që i kemi pas në këtë rregullore. Ne nuk i japim mbështetje kësaj rregullore dhe i ftoj të gjithë anëtarët e Kuvendit që mos ti japin mbështetje kësaj rregullore.

Urim Suka - tash kur jemi në prag të zgjedhjeve dhe klima politike i ka drejtimet e veta,është mirë secili prej nesh të përmbahemi sa kemi mundësi por të mos largohemi nga ajo pse jemi këtu,gjithnjë në mbrojtje të intersit të qytetarëve. Projekt rregulloret sa herë i kemi diskutu në grupin e LDK-së edhe kur jemi pajtu apo nuk jemi pajtu,gjithmonë i kemi shiku me syrin për m'i miratu. Edhe këtë projekt-rregullore e cila është për herë të parë,ne e kemi shiku me syrin e njejtë se si mund ta votojmë një rregullore të tillë. Seancën e kaluar,pas diskutimeve që i kemi pas në grup,njerëz tonë që janë ekspertë të fushës kanë dalë me vërejtjet e tyre konkrete dhe për arsyet që janë dhënë ne nuk e kemi votu dhe kemi qenë të lumtur se shumica e Asambleistave këtë projekt-rregullore e kanë votu kundër për ato vërejtjet që janë dhënë.Kur një dokument nuk kalon dhe nëse don me sjell edhe njëherë në kuvend,duhet m'u mbledh dhe të diskutojmë.Nëse vërejtjet tona nuk janë të bazuara dhe ju keni argumente që vërejtjet tona nuk duhet të inkorporohen,të diskutojmë dhe nëse bindemi që kjo është e mirë,atëherë le të vje herën e dytë.Është e papranueshme në formën si po vje. Edhe ne kishim pas dëshirë me votu nëse ishin inkorporu shumë mendime që i kemi thënë atëherë.Seancën e kaluar kjo rregullore ka pas me u prezantu me projektor sipas kërkesës sonë dhe përtej që keni marrë zotimin,që po,do ta prezantoni me projektor në seancë,atë ditë nuk e keni prezantu fare dhe sot prap s'po prezantoni asgjë. Si logjikë është gabim dhe unë kërkoj nga secili që mos ta votojmë sot dhe ndër dokumentet e para le t'i jetë barrë kuvendit të ri sepse edhe unë besoj që është një rregullore që duhet të miratohet,por pas ndryshimeve që ekspertata tonë i kanë propozu dhe ndoshta edhe ekspertë tjerë.

Qëndrim Elshani - tash po shihet qartë që arroganca e numrave iu ka kthyer në shprehje sepse ky diskurs i njëjtë po vazhdon sikur atëherë që i keni pas numrat dhe sikur tash që nuk i keni. Më vjen keq nëse kjo pikë kalon sepse qytetarët po mashtrohen që kjo pikë do ti shërbejë atyre sepse dihet që edhe po të kalojë nga Kuvendi komunal, në ministri kthehet mbrapsht sepse ka shumë gabime. Andaj unë ju bëj thirrje që mos ta kalojmë këtë pikë sepse ka shumë gabime dhe mos t'na kthejnë ashtu si është bërë zakon.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

14 për, 16 kundër, Nuk Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për hapjen e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit Plani Rregullues i Hollësishëm për „Zonën Ekonomike në Duhël“ ;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Sanie Kuçi Rexhepaj - Plani Rregullues i Hollësishëm për zonën e re ekonomike është një dokument strategjik që ndikon drejtëpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe urban të komunës tonë. Ai përcakton mënyrën se si do të organizohet territori publik, si do të ndërtohet infrastruktura dhe si do të krijohen kushtet për tërheqje e investime dhe hapje të vendeve të reja të punës. Udhëzimi administrativ për pjesëmarrjen publike në hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor që është i nxjerr nga ligji për planifikim hapësinor, e obligon komunën që të mbajë të paktën një diskutim publik në çdo fazë të hartimit të këtij plani. Ky është detyrim ligjor që siguron transparencë, pjesëmarrje dhe legjitimitet të projektit. Për këtë dokument është mbajtur vetëm një takim publik dhe ai ka pasur mangësi serioze në përfshirjen e palëve. Në atë takim janë ftuar vetëm bizneset që operojnë në Z.I. në Shirokë përmes ftesave të veqanta ndërsa janë përjashtuar bizneset tjera potenciale dhe investorët e rinj. Po ashtu në këtë takim janë trajtuar njëkohësisht dy zona ekonomike të ndryshme, gjë që ka shkaktuar konfuzion dhe ndërthurje të temave. Kjo ka pamundësuar një diskutim të qartë dhe të fokusuar për secilën zonë veq e veq. Në këto rrethana procesi nuk ka përmblusur as frymën e ligjit për planifikim hapësinor dhe nuk ka siguruar përfshirje reale dhe gjithëpërfshirëse të akterëve që do të ndikohen drejtëpërdrejtë nga ky plan. Andaj propozoj që ky draft-plan të mos procedohet më tutje në fazën e shqyrtimit publik por të rikthehet për plotësim të procesit të përfshirjes duke ndërmarrë këto hapa konkretë: të organizohen takime të strukturuar me biznese lokale dhe investor potencial për të diskutuar planet dhe nevojat e tyre për zhvillim dhe zgjerim në të ardhmen; Të përfshihen grupacione të ndryshme të interesit duke përfshirë komunitetet përreth, qendrën e biznesit, ndërmarrjet publike, shoqërinë civile si dhe të rinjtë dhe të rejtat e komunës; Të zhvillohen anketime të drejtuara posaqërisht të bizneset me qëllim mbledhjen e të dhënave të sakta për nevojat që kanë në aspektin e infrastrukturës, energjisë, aksesit në rrugë dhe shërbimeve mbështetëse; Të zhvillohen prezantime të ndara dhe të qarta për secilën zonë ekonomike; Të thirret një tryezë ndër-institucionale me përfaqësues të drejtorive komunale, kuvendi, sektori privat dhe shoqëritë civile për të kordinuar zbatimin afatgjatë të planit; Këto hapa që cekta nuk janë vonesë por janë garanci që do ta miratojmë, që plani të jetë i zbatueshëm, i mbështetur dhe në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm të komunës tonë. Andaj ju lutem kjo pikë të mos votohet tutje.

Selman Kolgeci - pushteti lokal po tenton që në fund të mandatit me miratimin e një zone ekonomike në Duhël por ne si opozitë e kemi shqyrtuar këtë projekt dhe kemi shumë dyshime e shqetësime serioze lidhur me planifikimin që është bërë në këtë zonë por edhe lidhur me formën e shfrytëzimit të hapësirave të dedikuara për sektor të ndryshëm. Pse nuk u kujtuat më herët ta bëni këtë zonë ekonomike gjatë gjithë këtyre viteve? Kjo na duket si një tentim për me marrë vota por jo projekt serioz për zhvillim. Unë e pash që aty ka pronë që është planifiku me 1400, 1500, 1600, 1700 dhe një 1834 m² dhe nuk di se kujt kemi me ia nda këto prona. Cili biznes mundet me ardhë me ofertë në 18 ari? Paradoksi është që në sipërfaqen 1834 m² është shkruar për industri të rëndë dhe sipas destinimit në këtë zonë lejohej edhe prodhimi i armëve. A mundet konkretisht drejtori me na tregu se cilat kishin me qenë kushtet zhvillimore të asaj parcele, distancë me rrugën, me parcelat fqinje? E di që është lënë mundësia për m'u bashku parcelat por akush nuk garanton që i njëjti ofertues ka me na ardhë me na ofertë në dy parcela ose i njëjti ofertues mundet me ardhë m'i marrë të dy parcelat. Fakt tjetër që kjo zonë ekonomike është projekt elektoral, është

që edhe KAB -in që e kemi parapa pas kësaj pike,nuk e kemi asnjë cent.Mbi bazën e çfarë logjike ekonomike të tregut janë përcaktu llojet e destinimeve për këtë zone?

Visar Kuçi - nuk është që mirarohet sot plani rregullues i hollësishëm në Z.E. në Duhël por sot ka ardhë në Asamble për me kalu një hap tutje dhe nëse kalon del në shqyrtim publik.Kur të del në shqyrtim publik ky dokument,teknikisht hartuesi i merr vërejtjet e juaja dhe nëse është brenda normave teknike dhe brenda normave të ligjit,pse mos me ndryshu.Kjo Asamble ia ka dhënë pëlqimin për m'i nis procedurat.I kemi nis procedurat dhe kemi ardhë në fazën për me marrë pëlqimin prej juve për me vendos në shqyrtim publik.Drejtori tutje jep sqarime.

Kryesuesi - bëhet fjalë për shqyrtim publik dhe nëse e merr miratimin për shqyrtim publik ka mundësi dhe ndryshon qasjen sepse merren për bazë kërkesat e bizneseve, qytetarëve.

Selman Kolgeci - e dimë që ka me dal në rishqyrtim por pse duhet me qu ne në rishqyrtim edhe m'i dhënë 18 ari në dokumentin që e ka kriju kompania e cila është pagu me taksat tona dhe m'i thanë: hajde se këtu ke mundësi me prodhu armë. Ne i kemi pa si kanë shku diskutimet publike dhe kemi pas vërejtje të vazhdueshme pikërisht për diskutime publike.Hajde ta rregullojmë sot një dokument i cili duhet me shku në diskutim te qytetarët, i cili duhet të jetë më i plotësuar e jo në këtë formë.

Visar Kuçi - në industri të rëndë nuk ka parcella 18 ari.Mund të përmirësohet gjatë rrugëtimit. Nuk përfundon me sot por nëse kalon ky plan,sot fillon me u punu.Drejtori tutje jep sqarime.

Mevlud Kabashi - harta është e vizatuar dhe e dalluar shumë bukur por për ne që nuk jemi ekspertë të fushës, ne nuk i kuptojmë ato ngjyra, ndarje që i keni bë.Ju është dasht ta keni hartën prezent para të gjithëve dhe me na interpretu ne detaje për me na bind neve.

Sanie Kuçi Rexhepaj - është e vërtetë që nga ana e Asamblesë është dhënë pëlqimi për me inicu hartimin e këtij dokumenti.Ky kuvend gjithmonë ka qenë i hapur dhe mbështetës për hartimin e dokumenteve planifikuese hapsinore por është e vërtetë edhe fakti që komuna nuk ka qenë edhe shumë respektuese ndaj këtyre pëlqimeve për vet faktin që e ceka më herët,ku thashë se nuk janë ndjek procedurat që duhet të ndiqen sa i përket angazhimit të pjesmarrjes publike gjatë hartimit të këtij dokumenti.Ne jemi të qartë që nuk jemi duke e miratu finalisht këtë dokumet sot por nëse i kishit kry procedurat paraprake atëherë kishim me u ndal dhe me analizu dokumentin.Për deri sa nuk janë kry obligimet ligjore,nuk ka mundësi vota të jetë pro.Komuna ka sjell dokumente edhe në të kaluarën për miratim dhe ky kuvend i ka miratu por sa ka raportu komuna për zbatimin e atyre dokumenetve,e din secili anëtar këtu sepse disa herë e kemi ngrit si shqetësim faktin që as PZHK,as për HZK,as për Plan të Mobilitetit dhe cilin do dokument tjetër që është miraru nga ky kuvend,nuk ka proces të monitorimit rreth zbatimit të atj dokumenti dhe nuk ka raportim vjetor siq është e dokumentume në PZHK,HZK dhe çdo dokument tjetër dhe siq kërkohet me ligj të planifikimit hapësinor.Po kërkon por nuk po angazhoheni tutje rreth atyre dokumenetve.

Alban Berisha - besoj që kolegët tonë asambleist në radhët e partisë tonë i dhanë mendimet e tyre profesionale dhe pajtohem plotësisht dhe i besoj profesionalizmit por shpesh unë si asambleist ndihem në pozicione të rënda "politike" sepse kur i ndëgjoj profesionistat e partisë tonë është një diçka që nuk duhet me kalu,dhe kur ta ndëgjoj ekzekutivin,më mbushet mendja që qenka e mirë për qytetarin dhe them pse mos me kalu.Po flasim për një dëgjim publik,për grupe të interesit,ne si asambleista të zgjedhur prej popullit dhe anëtar të një organi që nxerr dokumente dhe nuk po flas vetëm sot por po flas që 8 vite por me theks të veçantë 4 vitet fundit nuk e kemi pas të drejtën dhe mundësinë asnjëherë me inkorporu një mendim tonin. Thjesht ky organ ka qenë një organ që kur ka ardhë një projekt-vendim ose projekt-rregullore,vetëm a je pro ose kundër dhe kaq. Ne kemi dhënë argument për kundër,ekzekutivi ka dhënë argument për pro,por roli për të cilin jemi të thirrur ligjërisht ne kurrë nuk e kemi pas.Rasti konkret është për pikën që kaloi ku Flamuri propozoi që të ndërrohet njëra pikë,që anëtarët e komisionit m'u vendos prej Asamblesë dhe ka qenë shumë e thjeshtë me u ndërru një pikë.Nëse është e komplikune ajo pikë m'u ndërru,atëherë po dyshoj që diçka nuk është në rregull.Arroganca e numrave nganjëherë nuk sjell rezultate.Nëse është në interes të qytetarëve një dokument që vje këtu,unë nuk mund ta kuptoj pse? se atëherë pasi nuk qenka politike dhe nuk qenka në interesin qytetar,pse nuk thirremi edhe ne,shefat e grupeve që ta bëjmë një dokument për të mirën e qytetarëve.Pse ka qenë problem drejtor me inkorporu një propozim të Flamurit?Ky është rasti i fundit sepse ka edhe raste tjera.Ky mandat kaloi kryesues por të paktën duhet me iu respektu integriteti i një asambleisti sepse është në votën e qytetarit.

Flamur Bytyqi - drejtori tha që kanë qenë tri propozime prej kompanisë të cilat i ka shqyrtu komisioni prej Drejtorisë së Urbanizmit dhe e keni zgjedh njëren prej tyre dhe të njejtën kohë kemi pas edhe vërejtje të cilat i keni rregullu ju aty për aty. Pse nuk i merr për bazë kërkesat, ankesat e Selmanit dhe të Sanies, me përmirësu dhe me sjell seancën e radhë? për deri sa e paske një mundësi me i rregullu tash dhe për transparencën që u përmend. Ne kemi pas ankesa edhe për zonën ekonomike në Shirokë ku ju keni themelua një komision por ne atë raport nuk e kemi pa dhe nuk di çka ka ndodh.

Visar Kuçi - nuk ka qenë komision por ekip punues dhe ky ekip nuk është vetëm i Drejtorisë së Urbanizmit. Ndoshta 80% e këtij ekipi punues ka marrë pjesë edhe në dokumenta të tjerë. Ky ekip e ka hartu këtë draft deri në këtë fazë dhe të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet dhe kërkesat e secilit prej jush do të merren parasysh nëse janë brenda ligjit. Drejtori tutje jep sqarime. Sa i përket pyetjes së Albanit te pika e kaluar, unë nuk jam jurist por jam anëtar i ekipit dhe juristat në atë ekip kanë thënë që nuk mundet prej asamblesë por me vendim të Kryetarit të komunës bëhet komisioni për vlerësimin e bonuseve, dhe sa e di ai komision mandatin e ka 2 vjeçar. Ka qenë e pamundur me bo prej Asamblesë atë komision. Kemi pas takime edhe me ministrinë dhe na kanë dhënë sugjerime sepse me shumë kënaqësi edhe unë edhe zyrtarët e kishim heq këtë përgjegjësi dhe me ia dhënë asambleistave.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

13 për, 16 kundër, Nuk miratohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për periudhën 2026-2028;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - kjo kornizë buxhetore nuk përmbush kërkesat qytetare, ashtu edhe siç është parë në dëgjime publike ka qenë një numër shumë i vogël. Në disa lokalitete nuk pas asnjë njeri në dëgjime publike. Është i vetmi vit që unë nuk kam marrë pjesë në dëgjime publike por unë e kam thënë që disa vite që mos të shkojmë ti mbajmë dëgjimet publike e mos ta marrim asnjë kërkesë qytetare serioze. Ky projekt-buxhet është vetëm për gara elektorale ku te pjesa e projekteve kapitale nuk ka projekt strategjik dhe po e marr shembull fshatin tim ku janë disa rrugë që janë familjare dhe që 8 vite ka qenë kërkesë uji. Nëse rrugët ose një projekt tjetër është më prioritet se uji, atëherë ma thoni ju. Kjo kornizë buxhetore për grupin tonë nuk kalon.

Urim Suka - kur jemi te korniza afatmesme buxhetore, mendoj që është një nga dokumentet shumë të rëndësishme që ne si kuvendar miratojmë. U tha edhe nga Kryesuesi që kjo kornizë për me ardhë këtu kalon nëpër disa dëgjime buxhetore dhe në fakt jemi dëshmitar secili prej nesh se çfarë dëgjime buxhetore kemi pas. Unë sot do ti jap 2-3 shembuj se pse mendoj që kjo kornizë buxhetore është e përgaditur keq dhe nuk e meriton trajtimin tonë fare. Në fshatin Budakovë për vitin 2026 janë të planifikuara të ndërtohen rrugët: "Furra e UÇK-së, Ali Buqa dhe Sherif Buqa" dhe të njejtat rrugë i kemi miratu vjet që të shtrohen në vitin 2025. Nëse janë heq mjetet prej përmbaruesve dhe ka dështu si projekt, shumë mirë, por nëse s'ka ndodh kjo, është një gabim që po përcillet e njehta situatë. Të njajtat rrugë janë planifiku për vitin 2026-2027 për Budakovë dhe emrat e njejtë të rrugëve janë të planifikuara edhe për fshatin Bukosh. P.sh rrugët: „Behlul Bajrami, Dem Kololli dhe Kodra e Thatë“. Fakti që është bërë ky gabim edhe mundet me qenë teknik po tregon edhe seriozitetin kur e keni trajtu si dokument sepse këto rrugë s'munden me qenë edhe të Bukoshit dhe të Budakovës. Me kërkesë të banorëve unë isha në fshatin Greiqec. Në këtë kornizë është e planifikuar rruga „Naim Lubovci“ dhe rruga „Dëshmorët e Greiqecit“ dhe këto dy rrugë ishin të shtruara me asfalt. Në Javor asnjë rrugë nuk është e planifikuar. Atë që e kam ngrit më herët, te insatlimi dhe sanimi i ndriçimeve publike dhe te ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve, në të dy këto planifikime për vitin 2026 janë parapa nga 300.000€ por nuk e specifikon qartë. Nëse dojmë me planifiku mirë dhe nesër një realizim të mirë, unë mendoj që është mirë me i specifiku qartë sanimet dhe ndriçimet publike por edhe te kanalizimet. Ajo që mua më shqetëson dhe me që po vi vet nga Bllaca, kam disa shqetësime. Te hapësira për vorreza në Bllacë ndoshta në secilën kornizë buxhetore kur ka ardhë këtu unë e kam ngrit si shqetësim dhe kurrë nuk është marrë për bazë. Me vet iniciativ dikush ka shku dhe i ka vendos pikat dhe Drejtori Armend Krasniqi përtej që pat thënë që do të

bëjmë diçka, nuk ka bë asgjë. Së fundi ka qenë një varrim aty dhe secili qytetar aty e ka ndier veten në siklet për atë hapësirë, në therra. E kemi zgjedh me i nda nga 2 milion e nga 5 milion në Biraq dhe që s'jam kundër, por dikund 5 milion e dikund as 50.000, është e tyrpshme me lanë në atë gjendje. Në Bllacë është bë diçka te ujësjellësi por ka mbet përgjysme sepse gjysma e banorëve nuk kanë ujësjellës dhe është mirë të planifikohet. Vitin e kaluar kanë qenë dy kontrata për impiantin në Sllapuzhan dhe në fshtin Dubravë dhe nuk e di çka ka ndodh me ato kontrata sepse punët s'kanë fillu dhe tash ju keni parapa prap n'këtë buxhet nga 100.000€ dhe shpresoj kryhen por gjendja në Bllacë është emergjente edhe te impiantet, çështje që vazhdimisht e kam ngrit dhe nuk e keni adresu asnjëherë. Zgjerimi i shtratit të lumit dhe ndërtimi i urave, unë e pash që në disa fshatra janë të planifikuara. Gati çdo seancë kam kërku që edhe në Bllacë ura të rregullohet sepse ura që një kohë është pa rrethojë. Këto ishin disa shqetësime që unë kam dëshirë ti merrni parasysh të paktën në miratimin e buxhetit kur të vjen në shtator. Si të tillë këtë dokument, ne si grup parlamentar nuk e mbështesim.

Selman Kolgeci - Ajo që më intereson të dijë është se mbi cilin kriter po ndahen mjetet për rrugë të caktuara? A po dihet sa është gjatësia e tyre, çfarë pozicione kanë m'u punu dhe ku kanë m'u realizu?

Po vinë 10.000, 20.000, 70.000 shuma fikse dhe kjo tregon që nuk është serioz ky dokument. Po e filloj me fshatin Vraniq ku e kemi diskutu disa herë nevojën e investimit në parcellën e ndarë për varreza. Është therra aty dhe Kryetari thotë: e keni tokën e ndame. E kemi tokën por në therra e në shkurre nuk mund ti varrosim njerëzit tanë. Po ndani mjete në shumë lokalitete dhe shumë mirë që po ndani por edhe për Vraniq bëni diçka. Çështje tjetër është edhe investimi në kaptazhat e ujit të cilën e kam pas kërkesë disa herë. Çdo vit qytetarët në Vraniq shpenzojnë para të tyre, së paku gjysmë milion euro për me hap puse. Pse nuk është nda asnjë cent për këtë? Çështje tjetër janë kanalizimet për të cilën kemi diskutu disa herë dhe keni ardhë edhe ju Drejtor Shabani dhe Kryetari e ka pranë që ai investim prej 80.000€ ka dështu si investim. Kemi kërku përgjegjësi për atë dështim dhe prap sot ju nuk keni nda mjete për atë pjesë. Pashë që nuk keni planifiku asnjë ndarje buxhetore për pahitë elastike nën autostradë te krahu i majtë dhe rreziku për aksident aty është shumë i madh. Ndërtimi dhe rikonstruimi i varrezave në Biraq, unë nuk e kuptoj këtë! Ai ndoshta është vendi i vetëm në botë që duhet me minirat njëher për me hap varr sepse është kreq guri. I keni nda prap 345.000€ dhe janë investu qindra-mijëra euro aty dhe nuk e dimë çka ka ndodh dhe na duhet një raport me pa çka është bë aty dhe çka ka me u bë edhe me 345.000€ tjera. Te impiantet që i përmendi edhe kolegu, i keni pas në kontratë, i keni pas në plan të prokurimit por keni dështu. E keni kopju prej programit ton zgjedhor por nuk keni dit as me kopju. Shpresoj që ky keqplanifikim dhe ky keqprojektim buxhetor të mos pasqyrohet në buxhetin e vitit 2026 sepse nuk është buxhet qytetar por është buxhet puro për fushat elektorale të këtij viti.

Aziz Bytyqi - pajtohem me konstatimin thuajse të përgjithshëm sepse është shqetësim që në debatet publike nuk kemi pjesmarrje të kënaqshme të qytetarëve. Ndonëse informimi është bërë me kohë dhe debatet publike janë obligim ligjor që të mbahen dhe janë mbajtur rreth 30 dëgjime publike. Ky shqetësim ka qenë edhe në vitin 2013-2017 gjatë qeverisjes së kaluar. Më pëlqyen edhe diskutimet e parafolësve të opozitës sepse patën kërkesa konkrete. Ky dokument i jep orientim investimeve për tri vitet e ardhshme por shqetësimet për Peqan, Nishor, Bllacë janë legjitime. Unë kërkoj që këto shqetësime të bëhen pjesë e buxhetit për vitin 2026. Ju ftoj ta kalojmë si dokument këtë fazë dhe në shtator prioritet që i keni të bëhen pjesë e buxhetit për vitin 2026.

Vullnet Luzhnica - e përgëzoj Urimin për angazhimin por kanalizimi në Javor për herë të parë është i përfunduar mbi 1750 m dhe mbi 30 familje që janë lidh në atë pjesë. Është shumë e nevojshme me u bo edhe mbi 2000-3000 metra edhe për shkak të pozitës gjeografike atje mirëpo mos të harrojmë që atje 25 vite s'ka pas investim dhe tash po vjen një investim shumë i nevojshëm. Sa i përket zotimit për ndriçim publik, ajo ka qenë e përfunduar moti dhe e falemderojmë KEDS dhe KESKON për investimin që e ka sjell mirëpo mos të harrojmë që Luzhnica dhe Javori janë me infrastrukturë energjetike me Malishevë. Vitin e kaluar ka përfunduar investimi kapital i tensionit të nalt. Tensioni i ulët është projekt tjetër që pritet m'u implementu dhe në moment që vin shtyllat e betonit rreth rrugë atëherë fillon edhe ndriçimi.

Flamur Bytyçi - është njëri prej dokumenteve më të rëndësishme por kur po e shoh përmbajtjen e këtij dokumenti, po flet që është shumë i parëndësishëm për qytetarët. Personalisht kam dërgu kërkesë për disa prej projekteve por asnjëra prej tyre nuk është marrë parasysh, të paktën nuk kam marrë përgjigje zyrtare

as prej Kryetarit të komunës dhe as prej kabinetit qeveritar. Banorët e fshatit Peqan paskan me vazhdu me mbet pa ujë edhe këtë vit por ndoshta edhe shumë fshatra tjera. Njëra prej kërkesave të mija ka qenë: fasadimi i objekteve të banesat e Ballkanit mirëpo jo vetëm banesat e Ballkanit. Kërkoj sqarim se pse nuk kam marrë përgjigje për kërkesat që i kam bërë, të cilat janë kërkesa të qytetarëve.

Visar Kuçi - sa i përket investimit të banesat e Ballkanit dhe asaj pjese, komuna e ka nënshkruar një kontratë vitin e kaluar me një organizatë për efikasitet por fatkeqësisht ende nuk ka nis puna. Arsyeja se pse nuk e kanë nisur këtë investim është sepse janë duke i dhënë prioritet objekteve kolektive sociale në komunat tjera. E njëjta organizatë është duke e rregulluar me efikasitet shkollën teknike, shkollën e Reshtanit dhe shkollën Shkëndija.

Qëndrim Elshani - si çdo herë, edhe këtë herë KAB vjen me shumë padrejtësi dhe parregullsi. Nëse e analizojmë me detaje, mbi 90 % e projekteve janë të përqëndruara aty ku Kryetari ka pasur ose ka vota, ndërsa aty ku nuk ka pasur dhe nuk ka shprehur për t'i fituar, investimet janë pothuajse zero. Po ashtu ka shumë projekte që nuk po na vijnë për herë të parë por që kanë ardhur edhe në vitet e kaluara. Pse ndodh kjo? Për mendimin tim kjo është ose keqmenaxhim, ose keqpërdorim dhe këtë pres të na sqaroj ekzekutivi. Ju ftoj që mos të kalohet kjo kornizë buxhetore sepse është e dëmshme për qytetarët.

Alban Berisha - e përshëndes Azizën për kulturën politike që tregoi dhe me formën e ftesës për me votu këtë vendim, që kisha pas dëshirë edhe një lloj ftese e tillë me ardhë edhe prej ekzekutivit. Duke u ndërlidh me këtë, nuk e di Kryesues se si vjen një dokument kaq i rëndësishëm dhe akterët kryesor të hartimit të këtij dokumenti nuk janë të paktën me dal me paraqit orientimin. Pse nuk do ta votoj këtë dokument? Është larg asaj që e kemi parapa ne si parti politike mandatin e ardhshëm me vepru, dhe për këtë jam kundër sepse ky nuk është në orientimet tona programore.

Urim Suka - unë ngrita disa shqetësime dhe nuk mora përgjigje të rrugët në Budakovë dhe në Bukosh, ku janë të njëjtat rrugë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

14 për, 15 kundër, Nuk Miratohet pika 4

Pika 5. Pyetje dhe përgjigje;

Visar Kuçi - dua të kyqem me pikën e parë dhe të dytë që nuk kaloi për me qenë më transparent. E tha një fjalë Albani dhe Flamuri dhe unë jam në gjendje edhe si udhëheqës i ekipit dhe si Drejtor i Urbanizmit me thirr ekipin për rregulloren e bonuseve. Kërkesat dhe vërejtjet e juaja nuk i morëm as me shkrim dhe janë më shumë të përgjithshme. Me vendos rregulloren e bonuseve edhe një herë 14 ditë në shqyrtim publik sepse kemi të drejtë, dhe me i bërë ftesë secilit asambleist dhe me i marrë edhe kërkesat e juaja nëse janë të arsyeshme, dhe nëse janë kërkesat e arsyeshme, pse edhe mos m'i fut. Nuk po them që me ju bind me votu por nëse ka mundësi ky dokument ta kalojë edhe këtë fazë. Njëjtë po mendoj edhe të Plani Rregullues në Duhël. Nëse jeni të pajtimit i kisha shty këto dokumente edhe një herë.

Mevlud Kabashi - ti tani po na bën kërkesë neve për me bashkëpunu por unë pata kërkesë më herët që me na sqaru më në detaje hartën me ngjyra dhe nuk e more as mundimin më të vogël me dhënë sqarime. Sinqerisht unë nuk isha as kundër, as pro por prita sqarimin tënd dhe sqarimi yt ishte vendimtar për votën time. Nuk e di si me të besu ty kur e bën kërkesën e njëjtë por kërkesën që pata unë nuk e more për bazë.

Kryesuesi - ekipa tentoj me lidh por ishte e pamundur.

Visar Kuçi - unë kurrë nuk kam dëshirë me vendos në Asamblenë komunale një fotografi me sllajt. Dokumenti kur të vje në Asamblenë komunale ose kalon, ose nuk kalon. Ti nuk je eksperte e fushës dhe ke pas kohë 2 javë me pyet dikënd.

Sheqerije Zyrapi - A respektohet miratimi i buxhteit të viti të kaluar? Pse nuk kanë filluar punimet në segmentin e rrugës „Dëshmori i lirisë“ që është palnifikuar në vitin 2025 ndërsa kanë filluar punimet në rrugët që janë të planifikuara në vitin 2026? A është hapur tenderi për ndërrimin e dritareve në shkollën „Kongresi i Manastirit“ pasi është miratu ky buxhet? Kur priten punimet? Tjetër është ndriçimi të sheshi „Besim Ndrecë“. Ka katër vite që e kërkoj rregullimin e parkingjeve nëpër banesa ku banorët janë në gjendje edhe me bërë pagesën vetëm ta kenë një vendparking për vete.

Enver Shabani - kur përmende se a zbatohet KAB për vitin 2025,unë natyrisht e kam shqyrtu dhe e kam marrë me seriozitet këtë punë.Në vitin e kaluar për Studenqan janë të votuara rrugët: Ndërtimi i rrugëve lokale:“Eqerem Çabej,Arsim Gegaj dhe Gurra“ në Studenqan.

Shyqerie Zyrapi - te rruga „Arsim Gega“,unë kur e kam cek segmentin te rruga“Dëshmorët e lirisë“,unë nuk kam dit ku me orientu por e kam orientu te shtëpia e Arsimit Gegës për me ditë ku është rruga.Rruga nuk është e emërtune dhe pse nuk është duhet m'i pyet komisionet.

Enver Shabani - kur ka dal kompania projektuese me i bë paramast për rrugët,nuk kanë gjet asnjë rrugë me emrin Arsimit Gega.Nëse kishte me shkru segment,ne e kishim gjet.Do ta shqyrtojmë si mundësi.

Visar Kuçi - sa i përket emërimit të rrugëve,ne e kemi një listë rezervë.Nëse është rrugë e re dhe i plotëson kushtet m'u emërtu,duhet një kërkesë e një banori ose e një grupi të bëhet në Drejtorinë e Urbanizmit dhe nga lista rezervë e përzgjedhni emërtimin dhe ne e dërgojmë në agjension dhe agjensioni e aprovon.

Sheqerije Zyrapi - si me bë zgjidhjen e kësaj deri sa kjo është aprovu.

Gent Gashi - rruga „Dëshmorët e lirisë“ ku je duke thënë ti,nuk ekziston Arsimit Gega por ajo është rruga “Milit Gega“ -segment.

Urim Suka - kam një shqetësim të cilën e kam ngrit dy mbledhjet e kaluara.Çështja është për kompenzimin e dëmeve që iu ka shkaktuar bujqve.Drejtori është zotë që do formojë një komision dhe të dal në teren që ta bëjë vlerësimin e dëmeve për ata fermer.Me sa kam informacion vlerësimi i këtyre dëmeve nuk ka ndodh.Kompenzimin e këtyre dëmeve e bën një komision i cili është formuar në kuadër të zyrës së Kryeministrit me një vendim të viti 2022,por për me ndodh ky kompenzim për fermer,komuna duhet ta formojë një komision të ekspertëve që e bën vlerësimin.Nëse nuk formohet ky komision dhe nuk e bën vlerësimin e dëmeve,asnjë bujq i komunës tonë nuk mund të kompenzohet. Lus Drejtorin ta bëjë vlerësimin dhe komplet dokumentet e vlerësimit t'i dërgojë te zyra në Prishtinë sepse përndryshe fermerët dëmtohen.

Kushtrim Kuçi - pas shumë vërejtjeve që i kam pas te rruga „Skënderbeu“ ,njëra prej vërejtjeve është edhe shtyllat e ndriçimit që janë vendos,nuk janë vendos në rregull dhe sugjeroj drejtorinë që e ka pas në menaxhim t'i jap vërejtje kompanisë që e ka bë këtë punë,me rregullu sepse është shumë e pahijshme.Vërejtja e dytë është që në atë rrugë shumica e luleve janë tha.Kompania e ka bë një punë shumë të mirë por është më mirë të mbillen lule shumëvjeqare.

Dardan Berisha - te çështja e ekzekutivit dhe legjislativit duhet me bë dallimin.Çështja më e gabuar që mundohet në përgjithësi drejtorat m'i përfshi për me ndiku te asambleistat.Asambleisti e ka për obligim m'i sugjeru ekzekutivit kërkesat e qytetarëve sepse është i zgjedhur i qytetarëve.Ata që dojnë m'u zgjedh dhe me ardh në vendin tonë,gara është me 12 tetor.Drejtor të lutem mos e përdor injorancën ndaj kolegëve,konkretisht ndaj kolegës Mevlude.Shqyrtoje edhe një herë Drejtor DSHPE bashkë me Drejtorin e Inspektoriatit kërkesën e Shyqerie Zyrap sepse mund ta keni gabim ju,sepse unë e gjeta kërkesën.

Pyetja ime për Drejtorin DKA-së: komisioni për bursa ka përfunduar komplet procesin dhe ka disa nxënës dhe studentë që i kanë marrë mjetet dhe ka prej tyre që nuk iu kanë lëshuar mjetet.Ku qëndron problemi?

Nënkryetarja - janë disa gabime ku numrat e llogarisë nuk janë në rregull ose nuk janë pa mirë dhe u është kërku konfirmimi nga banka.

Selman Kolgeci - disa herë e kemi ngrit shqetësimin për mekanizma bujqësor që po ipen por nuk ka kontroll mbi to.Mekanizmat bujqësor ipen dhe atë ditë dalin në faqe të ndryshme të shit-blerjes mekanizmat bujqësor dhe kështu ka ndodh edhe tash.Ka qenë një kriter,që kush do që ka marrë vitet e kaluar,mos me marrë tash.Unë e kam analizu listen dhe ka familjet që kanë marrë vjet për vjet dhe ka individë të tjerë që punojnë dhe nuk kanë qenë përfitues të mjeteve bujqësore.Kjo praktikë është mjaft e keqe dhe shpresoj që ka m'u kriju një komision për kontrollin e këtyre mekanizmave.Pyetje për Drejtorin e DSHPE: a kanë projekte dhe leje ndërtimore rrugët dhe objektet që jeni duke i bë?Çështje tjetër është objekti ku jemi,ende pa u bë një vit,shih në çfarë gjendje jemi! Pres përgjigje nga Drejtori.

Nënkryetarja - nuk kam përgjigje për arsye se nuk kam qenë pjesë e komisionit por një gjë e di,që kërkesa ka qenë e madhe ku kanë qenë mbi 1400 këkesa.

Enver Shabani - sa i përket rrugëve për ndërtim se a kanë projekte dhe leje ndërtimi,disa kanë projekte dhe kanë leje të ndërtimit kurse disa nuk kanë as leje të ndërtimit dhe as projekte.Ato janë disa rrugica të vogla që kanë vetëm paramasë.

Visar Kuçi - nuk është problem te objekti,te materiali por problem është te rryma.Drejtori tutje jep sqarime.

Selman Kolgeci - Drejtori tha që janë disa rrugica por në fakt shumica e projekteve të kësaj qeverisje karakterizohet me rrugica në pronat private, oborre private e të ngjashme.Më intereson të di saktë, sa kanë?

Enver Shabani - bëje një kërkesë dhe të japim përgjigje.

Selman Kolgeci - Drejtor me juve e kam një praktikë të keqe në kërkesa.T'u kam drejtu disa herë me kërkesa për shumicën e projektev por ke thënë: jo,sepse edhe zyrtarët që punojnë aty kanë thënë që duhet me traktor me ti pru.Nuk është dasht me shku në këtë formë por është dasht me m'leju qasje në dokumente sepse ma lejon edhe ligji.

Enver Shabani - ju e dini që komuna e Suharekës është më transparente për qasje.

Selman Kolgeci - sot është dasht të diskutohet edhe çështja e auditorit dhe pikërsiht për projekte që po flasim ne, kemi vërejtje prej auditorit.

Kryesuesi - besoj në seancën tjetër vjen kjo pikë.

Liridon Fandaj - Drejtorit të Urbanizmit dy herë iu kam drejtu me shkresë zyrtare por nuk është përgjigj. Nëse ka përgjigje për lejen e ndërtimit të gjamisë në Shirokë ku ajo gjami ka ardhë në rend dite,ku edhe ka kalu por e ka kthi ministria për arsye se nuk është në përputhje me HZK-në.Te pjesa e rrugës për Peqan,a janë parapa kanalizimi dhe ujësjellësi në kuadër të asaj rruge? Te Therrtorja “Jetimat e Ballkanit”,a ka therrtorja leje ndërtimi ?A keni dal ndonjëherë aty me vizitu sepse aty po ndërtohet një shtëpi private.Nuk kam asgjë kundër por ligji duhet të respektohet për të gjithë barabartë.Drejtor i Inspeksionit,para disa dite kam pa disa postime që keni dal në shesh dhe në pjesën e lokaleve ku ato janë duke funksionu.Ato lokale po funksionojnë prap njejtë dhe nuk bën me iu mohu e drejta e lire e lëvizjes së asnjë qytetarit.Cilat janë masat që keni marrë dhe këto biznese a paguajnë diçka për komunën që e shfrytëzojnë hapësirat publike?

Visar Kuçi - nëse ke bërë kërkesë dhe s'të kam dhënë përgjigje,të kërkoj falje por do të interesohem.Më ke bërë një herë pyetje për xhaminë dhe të kam kthi përgjigje dhe kam thënë që materiali është bërë gabim dhe për atë e ka kthi ministria.

Liridon Fandaj - të kam dërgu kërkesë dy herë por nuk m'u ke përgjigj.Në kërkesë të kam pyet se e kujt është e drejta që një pronë publike jepet në shfrytëzim? Në Asamble ne e kemi votu një herë dhe ministria e ka kthi. Është dasht me ardhë në Asamble dhe me pais ti me leje.

Visar Kuçi - do ta marrë parasysh dhe do të përgjigjem dhe e di që xhamia ka leje dhe i ka plotësu kushtet.Sa i përket objektit të therrtores,ne e kemi pais me kushte ndërtimore me një procesverbal që ia kanë ndal ndërtimin Drejtoria e Inspeksionit,por jo me leje sepse është duke i plotësu dokumentet.Rruga e Peqanit është projekt që është përfitu prej ministrisë por saktë nuk e di.Do ta shoh projektin dhe të jap përgjigje.

Gent Gashi - sa i përket terasave,ne kemi dal në teren,po ashtu kemi dal me komisionin e Urbanizmit dhe kemi vendos shenja se deri ku kanë leje,deri ku po paguajnë taksa ata.Kemi edhe prej atyre që e kanë deviju vijën por ne do të marrim vendime tjera dhe do ti heqim.

Mevlude Kabashi - objekti i ri i qerdhes në Suharekë nuk ka klima dhe s'ka as perde dhe roleta.

Nënkryetarja - I kanë vendos klimat para dy dite në të gjitha dhomat.

Shyqerie Zyrapi - nuk mora përgjigje për pyetjet që bëra.

Enver Shabani - sa i përket ndriçimit në sheshin “Besim Ndreca” dhe në tërë territorin e komunës,ne e kemi një kontratë për sanimin dhe mirëmbajtjen dhe besoj që do të rregullohen shpejtë.

Visar Kuçi - është problem për banorët rezidentë problem i parkingjeve,sidomos me denimet që po marrin.Ne në Asamble kur e kemi hartu rregulloren e taksës e kemi fut si pikë por nuk ka apliku askush dhe besoj mund të bëjmë zgjidhje por duhet me apliku individualisht secili banor.